

VENDIM
Nr.740, datë 8.9.2010

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, TË CILAT PREKEN NGA ZGJERIMI I VARREZAVE PUBLIKE NË
BASHKINË E BILISHTIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5/1, 20 dhe 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga zgjerimi i varrezave publike, në bashkinë e Bilishtit.
 2. Shpronësimi bëhet në favor të bashkisë së Bilishtit.
 3. Pasuritë, në sipërfaqen prej 1800 (njëmijë e tetëqind) m² tokë arë, pronë private, që shpronësohen, si dhe lista e pronarëve që shpronësohen, janë sipas tabelës bashkëlidhur këtij projektvendimi dhe pjesë përbërëse e tij.
 4. Masa e shpërblimit të pronarëve, pasuritë, pronë private të të cilëve shpronësohen, është 450 900 (katërqind e pesëdhjetë mijë e nëntëqind) lekë.
 5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit të përballohet nga të ardhurat e bashkisë së Bilishtit, planifikuar në buxhetin e saj.
 6. Afati i përfundimit të procedurës së shpronësimit të jetë, 3 (tre) muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
 7. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet nga bashkia e Bilishtit.
 8. Afati i përfundimit të punimeve për këtë objekt të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga bashkia e Bilishtit për realizimin e tij.
 9. Regjistrimi i ri i pasurisë prej 1800 (një mijë e tetëqind) m² tokë arë, shpronësuar në favor të bashkisë së Bilishtit, të bëhet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
 10. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe bashkia e Bilishtit për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

TË DHËNAT MBI LISTËN EMËRORE TË PERSONAVE DHE PRONAVE QË DO TË
SHPRONËSOHEN PËR ZGJERIMIN E VARREZAVE PUBLIKE, NË BASHKINË E
BILISHTIT

NR.	EMËR, MBIEMËR	SIP. ARË M ²	ÇMIMI LEKË/M ²	VLERÄ LEKË	NUMRI I PASURISË	ZONA KADASTRALE
1	NEKTON PIRINGU	1800	250.5	450 900	858/15	3804
	TOTALI	1800		450 900		